



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 2118 / Prot.

Vlorë më, 11.11.2024

**VENDIM**  
Nr. 73 datë 20.11.2024

**PËR ÇELJEN E PROCEDURËS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË MBETUR  
VAKANT NË KOMISIONIN INSTITUCIONAL ZGJEDHOR (KIZ)**

Në mbështetje të nenit 38, të ligjit Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, nenit 6 të Rregullores "*Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, shkresës 2646, prot, datë, 19.11.2024, Senati Akademik në mbledhjen e tij të radhës datë 20.11.2024*

**VENDOSI:**

1. Të miratojë çeljen e procedurës për vetëkandidim për anëtar të Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ), në UV, për plotësimin e vendit të mbetur vakant, pas dorëheqjes së anëtarit përfaqësues i personelit akademik pranë Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore në (KIZ).
2. Periudha kohore e vetëkandidimeve zgjat nga data 21.11.2024 deri më 27.11.2024.
3. Vetëkandidimi dorëzohet në Zyrën e Protokollit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe do të administrohen nga sekretaria e Senatit Akademik.
4. Ngarkohet Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore për shpallje në faqen Web të vendimit dhe bërjen e njoftimeve përkatëse.
5. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Komisionit Insitucional Zgjedhor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Aurela Saliqaj**

